

**MIRË SE VINI NË ALPEX
KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE -KESH SH.A**

Me kënaqësi njoftojmë Anëtarin e ri të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike- ALPEX sh.a, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare -KESH SH.A.

KESH sh.a, me selinë e saj qendrore të vendosur në Tiranë, nënshkroi Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë duke u bërë Anëtari më i ri i ALPEX në Tregun e Ditës në Avancë.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a) është prodhuesi publik dhe në të njëjtën kohë prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Shqipëri. KESH ka përgjegjësinë për administrimin, operimin korrekt dhe garantimin e sigurisë teknike e operacionale të impianteve kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend, të cilat i ka nën administrim.

Kontakt

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a

Adresa: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,
Hyrja 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tirana, Albania.
Email: info@alpex.al